



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Shtator 2021

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Shtator 2021

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në edicionin e përmuajshëm të këtij buletini pasqyrohen aktivitetet për muajin shtator të vitit 2021)

Kërkohet përkushtim për zvogëlimin e numrit të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Anëtarët e Grupit punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike janë takuar me Udhëheqësin e Njësitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion dhe Udhëheqësen e Departamentit të Përgjithshëm të kësaj prokurorie, me ç'rast decidivisht kanë kërkuar një përkushtim më të madh në zvogëlimin e numrit të lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike dhe trajtimin e tyre me prioritet të lartë.



Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive ka mbajtur takim të radhës, në të cilin është diskutuar për hartimin e Raportit për zbatimin e Planit të punës së KPK-së për vitin 2021, zbatimin e Vendimit të Qeverisë lidhur me pandeminë COVID-19 për paraqitjen e stafit në punë dhe vaksinimin, format e mekanizimit të raportimit të kryeprokurorëve, si dhe shqyrtoi propozimet për plotësim-ndryshimin e këtyre formave, sipas rekomandimeve të anëtarëve të KPK-së dhe aktivitetet në zbatim të Sistemit për Menaxhimin Elektronik të Lëndëve (SMIL), me ç'rast themeloi Grupin punues për monitorimin e zbatimit të SMIL-it.



Diskutohen aktivitetet e administratës së prokurorive

Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (SKPK) ka mbajtur një takim me administratorët e prokurorive të Republikës së Kosovës, qëllimi i të cilit ishte trajtimi i çështjeve që ndërlidhen me funksionimin sa më të mirë të prokurorive, me ç'rast kërkoi nga ta që të kenë angazhim të vazhdueshëm për realizimin e objektivave dhe planeve të punës së prokurorive.



Administratorët shprehën gatishmërinë e tyre për angazhim të vazhdueshëm në realizimin e gjitha planifikimeve të parapara.

Diskutohen sfidat e ZMNV-ve

Në rrjedhën e aktiviteteve intensive gjatë këtij muaji, Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka mbajtur një takim online me menaxherin e Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndhimë të Viktimave dhe mbikëqyrësit regjionalë të Zyrave për Mbrojtje dhe Ndhimë të Viktimave, në të cilin u potencua se mbrojtësve të viktimave do t'u ofrohet ndihma e nevojshme institucionale për të përfaqësuar viktimat e dhunës në



familje, trafikimit të qenieve njerëzore, abuzimeve, keqtrajttimeve të fëmijëve, dhunimet, vrasjet dhe viktima të tjera të krimit.

Mbahet takimi i Grupit punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike

Grupi punues për mbikëqyrjen e Njësitit për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike ka mbajtur një takim pune, grup ky, i cili është funksional në bazë të Planit strategjik të sistemit prokurorial për periudhën 2019-2021, me ç'rast pati diskutime për hapat e



mëtejme, me qëllim të zbatimit të kërkesave të Këshillit Prokurorial dhe për angazhimet e tjera pas raportimit në Këshill për periudhën janar-qershor 2021.

Kryesuesit Maloku dhe Zogaj diskutojnë për përgatitjen e fazës së re të projektit TIK-SMIL

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka pritur në takim Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilin bisedoi për përgatitjen e fazës së re të Projektit TIK-SMIL për periudhën 2022-2024, fazë kjo, e cila parasheh avancimin e mëtejshëm të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) nëpër prokurori dhe gjykata, si dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit

në Kosovë, e cila planifikohet të finalizohet gjatë muajit nëntor të këtij viti dhe fillon së zbatuari nga 1 janari 2022 dhe financohet pjesërisht nga Qeveria e Mbretërisë së Norvegjisë.



Fillon puna për sistematizimin e administratës në sistemin prokurorial

Grupi punues për sistematizimin e vendeve të punës në administratën e sistemit prokurorial ka mbajtur takimin e parë, pas mandatimit të tij nga Komisioni për Çështje Normative (KPK), për hartimin e akteve nënligjore që rregullojnë sistematizimin e administratës së sistemit prokurorial, me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të administratës së sistemit prokurorial.



Mbahet takimi i radhës i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka mbajtur online takimin e 203-të me radhë, i cili filloi me raportimet e punës për gjashtëmuorin e parë të vitit 2021 nga Komisioni Mbikëqyrës për Zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të veprimit për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike nga Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik dhe kryetarët e komisioneve të përhershme të Këshillit Prokurorial të Kosovës, raporte këto, të cilat edhe janë miratuar nga anëtarët e KPK-së.



Më tej, takimi ka vazhduar edhe me njëftim lidhur me raportimet e kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës për periudhën prill-qershor 2021, raportime të cilat bëhen me shkrim.

Gjithashtu, KPK-ja mori vendim për dërgimin e propozimeve në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës për lirim të dy prokurorëve të Shtetit nga detyra, të cilët do të arrijnë moshën e pensionimit gjatë muajit tetor 2021.

Anëtarët e KPK-së miratuan me disa ndryshime kërkesën e UD së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së për çështjet e personelit dhe miratuan rivlerësimin e performancës së nëntë prokurorëve me mandat fillestar, si dhe mbajti seancë dëgjimore disiplinore për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Pejë.

Rastet e dhunës në familje, temë e takimit të Zëvendëskryesuesit të KPK-së me Zëvendësmministren e Drejtësisë

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Zëvendëskryeprokurorja e Shtetit, njëherësh Koordinatorë për rastet e dhunës në familje në kuadër të Prokurorit të Shtetit, kanë pritur në takim Zëvendësmministren e Drejtësisë me të cilën biseduan për angazhimin e vazhdueshëm të sistemit prokurorial të Kosovës lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës në familje. U tha se Prokurori i Shtetit këto raste gjithmonë i trajton me urgjencë dhe prioritet.

Bashkëbiseduesit u pajtuan të vazhdojnë bashkëpunimin lidhur me luftimin në përgjithësi të dhunës në familje, bashkëpunim ky, i cili do të vazhdojë edhe në kuadër të Grupit koordinues ndërministror kundër dhunës në familje në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2022-2026).



Strategjia për sundimin e ligjit, në fokus të takimit të Kryesuesit Maloku dhe Ministres Haxhiu

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe ai i Këshillit Gjyqësor janë pritur në takim nga Ministrija e Drejtësisë, ku diskutuan për zbatimin e Strategjisë për sundimin e ligjit dhe për Komitetin Drejtues të Strategjisë, sipas përbërjes që përcakton Strategjia, si dhe për çështje të tjera, të cilat rrjedhin nga zbatimi i saj.



Ministria, shprehu vullnetin e Ministrisë së Drejtësisë për zbatimin e objektivave të përbashkëta, të cilat dalin nga Strategjia për sundimin e ligjit dhe Plani i veprimit të strategjisë, si pjesë e reformës së rëndësishme në drejtësi, si dhe dy kryesuesit u shprehën të gatshëm për koordinimin e aktivizimit të Komitetit Drejtues të Strategjisë dhe zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit sipas kompetencave përkatëse.

Shqyrtohet Raporti gjashtëmujor i punës së Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i KPK-së ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin shqyrtoi Raportin e punës së këtij komisioni për periudhën janar-qershor 2021 dhe përmbushjen e Planit të punës në gjashtëmujorin e parë të këtij viti.



Rregullorja për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit drejtë finalizimit

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka mbajtur takimin e radhës, me ç'rast ka punuar në finalizimin e Rregullore për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit, si dhe ka caktuar anëtarët e grupeve punuese për hartimin e Rregullore për Organizimin e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Rregullore për Organizimin e Prokurorit të Shtetit.



Mbahet takimi i parë i Grupit punues për hartimin e draftit të Rregullore për zgjedhjen e drejtorit të SKPK-së dhe NJSHP-së

Ndërkaq, Grupi punues për hartimin e draftit të Rregullore për zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit të SKPK-së dhe të NJSHP-së ka mbajtur takim e tij të parë, ku diskutoi metodologjinë, konceptet dhe parimet kryesore, të cilat do të jenë bazament i hartimit të draftit të Rregullore për zgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorit të SKPK-së dhe NJSHP-së, e cila është një akt nënligjor i rëndësishëm në kuadër të zbatimit të kompetencave të udhëheqësve të lartë administrativë të sistemit prokurorial.



Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariati i KPK-së ka dërguar në Zyrën e Kryeministrit një raport për zhvillime e fundit në sistemin prokurorial, i cili do të shërbejë për hartimin e Raportit për Kosovën të Komisionit Evropian, si dhe është përgatitur një vlerësim për projektin e realizuar në sistemin prokurorial "Promovimi i sundimit të ligjit në Evropën Juglindore".

SKPK-ja, gjithashtu, ka mbajtur takime për diskutimin e aktiviteteve kryesore për buxhet, financa dhe shërbime të përgjithshme, me qëllim të koordinimit të tyre, me ç'rast është hartuar Raporti i realizimit të buxhetit sipas programeve dhe kategorive ekonomike për periudhën janar-gusht 2021 dhe Raporti i punës së Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel për periudhën janar-qershor 2021.

Nga ana tjetër, versioni final i draftit të Projektit të SMIL-it të fazës transitorë për periudhën 2022-2024 iu është dërguar përfaqësuesve të administratës së Gjyqësorit të Norvegjisë, si dhe ka filluar avancimi i Sistemit për Menaxhimin e Rasteve për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, i cili përfshin regjistrimin e të gjitha veprimeve dhe gjenerimin e raporteve të avancuara.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (NJSHP) ka zbatuar procesin e transferimit të dosjeve të prokurorëve nga NJSHP te Divizioni i Burimeve Njerëzore, siç përcaktohet me Rregulloren për Dosjen Personale të Prokurorëve, si dhe ka punuar edhe në draftin e Rregullores së NJSHP-së, i cili ka të bëjë me Zyrën për Statistika, raportet statistikore për gjendjen numerike të rasteve për muajin gusht për prokuroritë themelore, Prokurorinë Speciale dhe të Apelit, pastaj raportet për ngarkesën e prokurorëve me lëndë dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre gjatë muajin korrik për të gjitha prokuroritë, përveç ZKPSH-së.

Ndërkohë janë përgatitur edhe të dhënat statistikore të veçanta për kallëzimet penale të parashtruara nga

ATK-ja për vitet 2015, 2016, 2017, 2018, 2019 dhe 2019, si dhe është në proces të hartimit të Planit për vlerësimin e nevojave për trajnimin e prokurorëve në bazë të të dhënave të ofruara nga kryeprokurorët, planeve individuale për identifikimin e trajnimeve për prokurorë nga të gjitha nivelet e prokurorive, dokument ky i politikave të trajnimit, që do të miratohet në KPK-ja dhe janë realizuar disa trajnime online në kuadër të Programit për trajnime të vazhdueshme për krimin e organizuar dhe korrupsionin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në rastet e shkurorëzimit dhe rastet e dhunës në familje, parandalimin e torturës (Artikulli III i Konventës së Stambollit), uzurpimi i paligjshëm dhe rikthimi i pronave, kriptovalutat dhe pastrimi i parave, zhvillimi i hetimeve, hartimi dhe ngritja e aktakuzës, si dhe përdorimi i Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL).